

Memorandum i Mirëkuptimit

Në mes të

Programit për Juristët në Kosovë (PJK)

Dhe

Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK)

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MiM) është themelimi i bashkëpunimit në mes të PJK dhe OAK në ndërmarrjen e përpjekjeve të përbashkëta për zhvillimin dhe ngritjen e mëtutjeshme të Profesionit të Juristit në Kosovë, bazuar në fushëveprimin e aktiviteteve të përcaktuara më Programin për Juristët në Kosovë.

Neni 2

Obligimet e PJK

- 2.1** PJK obligohet të mbështes Odën e Avokatëve të Kosovës në promovimin e ekselencës juridike të anëtarëve të saj, si dhe të avancojë shërbimet e ofruara në Arsimimin e Vazhdueshëm Ligjor të Obligueshëm.
- 2.2** PJK obligohet të mbështes OAK në tërheqjen e anëtarëve nga grupet më pak të përfaqësuara, duke përfshirë femrat dhe pakicat, si dhe të fuqizojë zyrat regjionale të OAK në dhënien e shërbimeve për anëtarët e tyre.
- 2.3** PJK obligohet ti vë në dispozicion OAK-së ekspertizën e trajnuesve *pro bono* të Programit, në bazë të nevojave të identifikuara të OAK-së në programin e saj për arsimimin e vazhdueshëm ligjor të obligueshëm të avokatëve.

Neni 3 Obligimet e OAK-së

OAK e njeh dhe e pranon PJK si partner në ngritjen e mëtutjeshme të Profesionit të Juristit në Kosovë dhe zotohet të mbështes iniciativat e përbashkëta në kuadër të planit të punës të Programit për Juristët në Kosovë.

Neni 4 Kohëzgjatja e Memorandumit

- 4.1 Ky MiM nënshkruhet për periudhën 1 (një) vjeçare, me mundësi vazhdimi.
- 4.2 Në rast se asnjëra nga palët nënshkruese nuk e paralajmëron shkëputjen e këtij MiM një muaj para përfundimit të tij, MiM konsiderohet të jetë vazhduar me automatizëm.
- 4.3 Kohëzgjatja maksimale e këtij MiM është 3 (tre) vite (2012 – 2014).


Neni 5 Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga palët.

Në pajtim të plotë, palët e nënshkruajnë këtë Memorandum të Mirëkuptimit më 24 shkurt 2012.


Programi për Juristët në Kosovë
Harold D. Dampier, Jr.
Shefi i Zyrës




Oda e Avokatëve të Kosovës
Ibrahim Dobruna
Kryetar

